

MINISTERI VË  
KUVENDIT KOMUNAL  
DITËSI JEDHE  
02/218



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së-I- (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajtë në sallën e Kuvendit Komunal të Malishevës më datën 13.06.2025 prej orës 10:50.

Në takim mörën pjesë: Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ekrem Kastrati, Kryesusi i Kuvendit z.Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi, Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër z. Bashkim Krasniqi ,Drejtori i Inspektoriatit z. Hafir Rexha ,Drejtori për Urbanizëm z.Avdi Rudi,Drejtori për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Sylë Dukollit të pranishëm ishin 16 Asambleistë si dhe Zyra e Informimit .

**Kryesus i Kuvendit Komunal të Malishevës Argjend Thaçi:**Përshëndetje për të gjithë.I nderuar Kryetar i Komunës z.Kastrati ,të nderuar Drejtorë të nderuar media mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës për këtë mbledhje kemi dy pikat të rendit të ditës të cilat janë:

**R E N D I D I T Ë S**

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/691 data 11.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" i Komunës së Malishevës, për vitin 2025, humanistik z.Halil Kastrati.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/0711 datë: 12.06.2025,e parashtruar nga Kryetari i Komunës për miratimin e vendimit të Këshillit Organizativ,për ndarjen e mirënjohjeve.
- 3.Të ndryshme .

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:** Me qcnëse kemi senacë të jashtëzakonshme nuk kemi shtuar ndonjë pikë tjeter të rendit të ditës. Atëherë e hedh në votim kush është për miratimin e rendit të ditës?

Miratohet rendi i ditës me vota unanime nga 16 të pranishëm.

Për 16 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi :** Nëse ju pajtoheni së pari do ta lexoj pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/711 datë: 12.06.2025, e parashtuar nga Kryetari i Komunës për miratimin e vendimit të Këshillit Organizativ, për ndarjen e mirënjojçeve.

Pra kërkesa nr.01/711 propozim për miratimin e vendimit të Këshillit Organizativ për ndarjen e mirënjojçevë konform nenit 9 të statutit të Komunës. Të nderuar antarë të Kuvendit Komunal të Malishevës Këshilli Organizativ i forëmuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Malishevës pasë shqyrtimit dhe propozimit të bërë nga antarët e Këshillit Organizativ vendosi që në pajtim të nenit të 9 të statutit të Komunës vendosi që ti nderojë këto personalitet për ndarjen e çmimeve të cekura si në vijimë.

Këshilli Organizativ propozon Kuvendit të Komunës së Malishevës për miratim për ndarjen e çmimit për "Imer Krasniqin" për trimëri dhe heroizëm Këshilli Organizativ që të dërgonë në Kuvend për miratim propozimin e Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dega në Malishevë Naser Shala post mortum, Tahir Ulluri Marali, Feim Thaçi Mirushë post mortum, Hajdin Berisha Gurëbardhë post mortum dhe Hajrullah Mazreku nga Malisheva post mortum.

Ndërsa për çmimin "Hamdi Berisha" për kontributin e dhënë në shkollën shqipe poropozonë Sylejman Telaku Banjë dhe Haxhi Kastrati Maxharë.

Kurse për çmimin "Dr. Shpëtim Robaj" për kontributin e dhënë në fushën e mjekësisë janë Dr. Haki Balaj post mortum Fatime Gashi-Mazreku Malishevë dhe Shehide Hoti-Gashi Carallukë pra konfirmojë se këto propozime janë miratuar në mënyrë unanime nga të gjithë antarët e Këshillit Organizativ dhe me votë unanime janë të rekonduarë për në KPF e po ashtu edhe për në Kuvend janë votuar në mënyrë unanime. Nëse ka dikush diskutim për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni. Përfjalë është lajmëruarë Nebih Bibaj urdhëro.

**Nebih Bibaj (antarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës) :** Faleminderit Kryesus, i nderuar Kryetar koleg Asambleistë sigurishtë që ne si grup parlamentarë e kemi mbështetur kërkcsën e Veteranëve dhe të gjithëve.

Këta janë njerzë të nderuar prej anës tonë sepse secili në periudha të ndryshme gjatë luftës, në mjekësi, në arsim kanë dhënë kontributin e tyre dhc ne si grup i mbështesim fuqishëm për propozim të cilat i ka bërë Këshilli.Ju faleminderit.

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:**Faleminderit Nebih.A ka dikush tjetër që dëshironë me marrë fjalën.Fjalën e ka kërku shefi i grupit parlamentarë të Asambleistëve nga Nisma Socialdemokrate Halil Morina.Urdhëro Halil.

**Halil Morina(antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):**Faleminderit Kryesus ,i nderuar Kryetarë i Komunës të nderuar Asambleistë të nderuar Drejtori njëjtë edhe ne si grup parlamentarë e kemi pasur edhe përfaqësuesin tonë në atë komisionë dhe ne e mbështesim vendimin e këtij Komisioni për këto tri kategoritë që ne e ndajmë çmimin si Komunë.

Pra shumicën e tyre i njohë personalishtë ajo qfarë për mua është pak shqetësuese dhe e dhimbshme është kur i shohë që shumica prej tyre janë vetëm post mortum sidomos kur bëhet fjalë për çmimin për trimëri sepse të gjithë këta që janë propozuar kanë shkuarë në moshë të re pra është e dhimbshme por pasojat e luftës e bëjnë këtë gjë.

Kështu që në në mënyrë unanime e mbështesim dhe e votojmë për propozimin që e ka bërë Këshilli Organizativ.Ju faleminderit.

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi :**Faleminderit Halil .Fjalën e ka kërku Veton Zogaj.Urdhëro Veton .

**Veton Zogaj(antarë nga rradhët e Lëvizjes Vetëvendosje):**Faleminderit Kryesus.Përshëndetje për të gjithë.Ashtu si në KPF edhc këtu ne si grup parlamentarë e mbështesim propozimin qoftë prej shoqatave apo institucioneve tjera .

Ajo qfarë kisha dashtë në të ardhmën që me përmirësu është që sikur për kategoritë e tjera që i kemi që me gjithë atë edhe pse ishin të mangëta biografitë me na ardh propozimet që vijnë prej shoqatave me qenë të plota të paktën nëse ata nuk munden me bërë e bëjmë ne si institucion.Kaq kisha për të thënë .Ju faleminderit shumë .

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:**Faleminderit shumë Veton .Atëherë nëse nuk ka dikush tjetër për me marrë fjalën e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës :Kërkesën numër 01/711 data 12.06.2025 e parashtruarë nga Kryetari i Komunës për miratimin e vendimit të Këshillit Organizativ për ndarjen e mirënjojheve.

Miratohet në mënyrë unanime nga 16 të pranishëm kjo pikë e rendit të ditës.

Për 16 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rradhës e cila është : Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/691 data 11.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" i Komunës së Malishevës, për vitin 2025, humanist z.Halil Kastrati.

Atëherë e stojmë Kryetarin e Komunës z.Ekrem Kastratin që ta lexojë kërkesën dhe arsyeshmërinë e tij me të cilën ka kërkuarë që të bëjë ndarjen e çmimit për "Qytetar Nderi" për humanistin z.Halil Kastrati.

**Kryetar i Komunës së Malishevës z.Ekrem Kastrati:** Kryesus faleminderit shumë,Ju falendrojë që në mënyrë unanime e votuat propozimin e Këshillit Organizativ për nder të Ditës së 16 Qershori Ditës së Çlirimit në Malishevë Ditës së Dëshmorëve .

Gjithashtu i uroj për zemërsisht për çmimin e personalitetit të ndaruar familjet e tyre për çmimin ku disa prej tyre tanë këto nderime janë vetëm post mort.

Tani më lejoni një fjalë rasti siq edhe c kemi marrë ftesën e kësaj scance të jashtëzakonshme për pikën e dytë ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" për humanistin z.Halil Kastrati e që i bie sot ta miratojmë këtë propozim për ndarjen e këtij çmimi.

Ndërsa ceremoninë solmc për ndarjen e këtij çmimi do ta bëjmë për një datë tjetër jo më 16 Qershori ne do të jemi në bashkëpunim me juve dhe zotri Halil Kastratin.  
Më lejoni që fillimisht të flas dy fjalë të shkurtëra për personalitetin e humanizmit të zotri Halil Kastratin.

Sot ai njihet nga ne e kudo që jetojnë populli shqiptarë.

Zotri Halil Kastrati ka lindur më:17 Prill 1975 ,ka të përfunduarë studimet Universitare në Drejtimin e Psikologjisë.

Mirëpo siq e njohim ne të gjithë për kontributin e madh të tij human i cili e ka bërë dhe vazhdonë të bëjë bamirësi aktivitetin humanitar ku kryesisht është fokusuar në përkujdesjen e jetimëve dhe familjeve me gjendje të vështirë sociale.

Zotri Halil Kastrati është themelues dhe njëherit Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" e cila ju ofronë ndihmë për strehim ,ushqim e shumë gjëra të tjera esenciale për familjet në nevojë në Republikën e Kosovës e të Shqipërisë dhe shumë vende të tjera të Ballkanit.

Personaliteti i Halil Kastratit dhe kontributi i tij ka prekur secilën pjesë të trojeve tona edhe duke qenë bashkëvendas i joni ai jo rrallë herë ka kontribuarë edhe në territorin e Komunës tonë përmes Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit "me të cilën do ti përmenden disa nga aktivitetet që ka kryerë në Komunën tonë :ka ndihmuar me pakë ushqimore,ka ndërtuar shtëpi ose ju ka blerë banesë familjeve në nevojë,ju ka ndihmuar familjeve që kanë pasur ndonjë antarë të familjes të diagnostikuarë me ndonjë sëmundje.

Fatëmirësish Komuna e Malishevës e ka bërë publike tani më ka hapur një dritare të re bashkëpunimi me këtë Shoqatë Bamirëse dhe së shpejti do të filloj procesi i implementimit të projekteve të mëdha në qytetin tonë siq janë :Qëndrim ditor për të moshuarit,Qëndrim ditor si dhe kujdes shëndetësor përfëmijët me nevojë të veqanta .

Personaliteti i Halil Kastratit ose më mirë të themi kontributi i tij humanë është nderuar edhe nga institucionet më kredibile në mbarë trojet shqiptare dhe më gjërë.

Çmimë dhe Mirënjoyje ka marë shumë ai ka marrë Mirënjoyje nga Kryeministri i Shqipërisë zotri Edi Rama ,Çmimin Ndërkombëtar për Bamirësi nga Fondacioni dy herë prej Turqisë dhe Presidenti i Turqisë zotri Rexhep Tajip Erdoan,"Qytetar Nderi "është shpallur në Komunën e Mitrovicës dhe Podujevës ,”Qytetar Nderi”i Kukësit dhe Lezhës,Mirënjoyje nga Bashkësia ISLAME e Kosovës ,”Medalje Presidenciale” Nëna Terezë,”Dekorata” e Gjergj Kastrioti Skënderbeu ,Ambasadorë i vullnetit të mirë nga Ministria e Jashtme .

Pra të nderuar antarë të Asamblesë Komunale kjo ishte një përshkrim i shkurtër për biografinë e zotri Halil Kastratit kështu që duke u pajtuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 në bazë të Gazetës Zyrtare të Kosovës Nr,28 /04 Qershori 2008 Neni 4,Neni 8 ,Neni 10 dhe Neni 17 paragrafi 18 shkronja r),Neni 40 paragrafi 40.2 shkronja h),Neni 58 paragrafi 58.1 shkronja a),b),c),g),h),m) dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës propozojë para juve që të merni një vendim dhe njëherit të shpallni ”Qytetar Nderi” personalitetin e humanistit të njobur zotri Halil Kastratin.

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:**Faleminderit Kryetar e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës ,Halil Morina e ka kërku fjalën .Urdhëro Halil.

Halil Morina (antarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit edhe njëherë Kryesus.Faleminderit Kryetar për propozimin dhe leximin e biografisë së humanistit të nderuar zotri Halil Kastratit.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për aktivitetin e tij të jashtëzakonshëm humanitarë jo vctëm për Komunën tonë por në përgjithësi për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Ky çmim i dedikohet më tepër pasi që vjen prej Komunës tonë.

Ne e kuptuam që shumica e qyteteve i kanë ndarë çmime të tilla duke filluar nga figurat ndërkombëtare kështu që edhe ky propozim prej Komunës tonë është shumë i qëlluar.

Unë shfrytëzojë rastin me falenderu Kryetarin e Komunës z.Ekrem Kastratin për angazhimin e tij për të gjetur bashkëpunim me organizatat të ndryshme humanitare siq është edhe në këtë rast me Shoqatën ”Jetimat e Ballkanit” dy projekte shumë të rëndësishme dy projekte shumë të mëdha për dy kategoritë të ndjeshme të shoqërisë tonë të cilat bëhet fjalë përfëmijët me nevoja të veqanta dhe personat e moshuarë .

Këto dy projekte shumë të mëdha me angazhim shumë humane të cilat i ka bërë Kryetari jonë i Komunës në bashkëpunim me humanistin z.Halil Kastratin .

Kështu që unë jam i nderuar dhe po flas edhe në emër të grupit parlamentarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate me plotë dëshirë që me votu për këtë kërkesën e propozuar nga Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati.

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:**Faleminderit i nderuar Halil.Fjalën e ka kërkuar Veton Zogaj.Urdhëro Veton fjala për juve.

**Veton Zogaj (antarë nga rradhët e partië Lëvizja Vetëvendosje):**Faleminderit Kryesus ,c ndjej pak për obligim këtë qështje të cilën e kam ngritur në mbledhjen e KPF-së që ta diskutojë edhe në këtë seancë.

Sigurisht që ne e njohim të gjithë veprimtarinë e zotri Halil Kastratit për punën që c bënë me Shoqatën "Jëtimat e Ballkanit" të cilën ai e udhëheqë.

Mirë do të kishte me qenë sikur të ishte prezent Muharremi me na jep një interpretim ligjor sa i përket ndarjes së çmimit do me thënë a ka ndeshje ligjore pasi që ai i përket prejardhjes nga Komuna jonë mirëpo nuk është banor i kësaj Komune .

Ne nuk e kontestojmë kontributin e tij human mirëpo vetëm kjo ishte një dilema se a ka ndeshje ligjore nëse e shpallim "Qytetar Nderi "banori i cili i përket ndonjë Komune tjeter edhe pse ne tash më e dim që ai në disa vende është shpallur "Qytetar Nderi " prandaj do të ishte mirë me na jep një sqarim .Ju faleminderit shumë .

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:**Faleminderit shumë Veton.Fjalën e ka kërkku Kryetari i Komunës z.Ekrem Kastrati.Urdhëro Kryetar.

**Kryetar i Komunës Ekrem Kastrati:**I nderuar Veton vërtetë kjo pyctje është me vend sepse edhe ne e kemi diskutuar si qështje ndoshta do të kishim shkuarë edhe më herët me këtë proccdurë por jemi marrë me procedura dhe gjithqka është në rregull.

Halil Kastrati është banor i qytetit të Prizrenit kurse prejardhjen e ka prej Komunës së Malishevës në fakt babi i tij ka lindur në Bubël kurse ai ka lindur atje kështu që ne nuk e kemi pasur asnjë dilemë edhe pse ai është lindur atje dhe jetonë atje edhe një herë ne e konfirmojmë që ai e ka prejardhjen prej këtu dhe nuk ka asnjë dilemë për ndarjen e çmimit.Ju faleminderit shumë .

**Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi:**Faleminderit shumë Kryetar.

Atëherë c hedhim në votim miratimin e kërkesës nr.01/691 datë:11.06.2025, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" i Komunës së Malishevës,për vitin 2025,humanistik z.Halil Kastrati.

Kush është për miratimin e kësaj pike të rendit të ditës?

Ju falenderojë shumë për pjesëmarjen.

Nga 18 Asambleistë të pranishëm miratohet në mënyre unanime kjo pikë e rendit të ditës.  
Për 18 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

**Pika e tretë e rendit të ditës :Të ndryshme.**

**Kryesus i Kuvendit Argjend Thaçi:**A ka dikush me marrë fjalën. Atëherë nëse nuk ka me marrë dikush fjalën për sot po e mbyllim me kaq takimin.

Takimi përfundoj rrëth orës: 11:15

Procesëmbajtsja

Kryesus i Kuvnedit

Fatlume Delija

